



**BANKA E SHQIPËRISË
REGJISTRI I KREDIVE**

FORMULARI I KËRKESËS PËR RAPORTIN E KREDIMARRËSIT

Ju lutem plotësoni këtë formular për të mundësuar trajtimin e kërkesës suaj. Gjithashtu, bashkëlidhni me këtë kërkesë një kopje të dokumenteve shoqëruese të listuara më poshtë, të cilat janë të nevojshme për identifikimin tuaj nga Regjistri i Kredive për çdo kërkesë. Ju do të merrni nga ne brenda 10 ditësh një përgjigje në lidhje me depozitimin e Kërkesës suaj për Raportin e Kredimarrësit. Nëse brenda 10 ditësh nuk merrni asnjë njoftim, ju lutem telefononi në numrat: 04 2419301; 04 2419302; 04 2419303.

| | | |
|---|---|---|
| Për: | Banka e Shqipërisë, Regjistri i Kredive, Sheshi "Skënderbej", Nr.1, Tiranë, Shqipëri. | Vetëm për përdorim zyrtar të BSH |
| Nga: | Emri, atësia, mbiemri i kërkuesit: Nr.Pasaporte/Certifikatë Lindjeje/Letërnjoftimi/Kartë Identiteti: Datëlindja: Adresa e vendbanimit: Nr. i telefonit: | Nr. Reference: Data e pranimit: Punonjësi i ngarkuar: |
| Dëshiroj një kopje të Raportit të Kredimarrësit për: <input type="checkbox"/> Veten time <input type="checkbox"/> Të përfaqësuarin <i>(emri, atësia, mbiemri i individit/personit fizik)</i> <input type="checkbox"/> Subjektin _____ në zbatim të detyrimit ligjor/vendimit të gjykatës <i>(nëse është individ/person fizik shënoni emrin, atësinë, mbiemrin; nëse është person juridik plotësoni të dhënat e mëposhtme për personin juridik)</i> <input type="checkbox"/> Personin juridik Emri i personit juridik _____ Numri i regjistrimit _____ Statusi ligjor (Sh.a, Sh.p.k, etj.) _____ Data e regjistrimit _____ | | Shënime: |
| Marrja e kopjes: <input type="checkbox"/> Dëshiroj të marr kopjen e raportit personalisht në Zyrën e Regjistrimit të Kredive, pranë Bankës së Shqipërisë <input type="checkbox"/> Dëshiroj që personi i autorizuar nga unë, të marrë kopjen e raportit personalisht në Zyrën e Regjistrimit të Kredive, pranë Bankës së Shqipërisë | | |
| Nënshkrimi: _____ Data: _____ | | |

Ky formular mund të merret pa pagesë nga faja zyrtare e internetit të Bankës së Shqipërisë https://www.bankofalbania.org/Mbikëqyrja/Regjistri_i_Kredive/Raporti_i_Kredimarrësit/ ose pranë ambienteve të BSH në Tiranë. Ju lutem dorëzojeni këtë formular dorazi në ndërtesën qendrore të BSH në Tiranë në adresën e shënuar në formular. Mos e dërgoni nëpërmjet e-mailit apo me postë.

Dokumentacioni shoqërues

Për të mundësuar trajtimin e kërkesës suaj, formularit të mësipërm Ju lutemi t'i bashkëlidhni dhe dokumentacionin si në vijim:

A. Kur kërkesa i referohet pajisjes me Raportin e Kredimarrësit si **“INDIVID”**:

1. Një kopje e dokumentit të identifikimit të subjektit të të dhënave (kredimarrësit) si dhe një dokument brenda afatit të vlefshmërisë së tij, që të përmbajë edhe atësinë e subjektit të të dhënave (të tillë si certifikata familjare/personale etj.);
2. Në rast se kërkesa dorëzohet nga një person i autorizuar nga subjekti i të dhënave, atëherë përveç dokumenteve të përcaktuara në pikën 1 më lart, nevojitet të dorëzohet gjithashtu dhe një prokurë origjinale apo autorizim i posaçëm, i lëshuar nga subjekti i të dhënave për personin e autorizuar, si dhe një kopje e dokumentit të identifikimit të këtij të fundit.

B. Kur kërkesa i referohet pajisjes me Raportin e Kredimarrësit si **“Subjekt Tregtar”**:

1. Një kopje e noterizuar e “Ekstraktit Historik të Regjistrimit Tregtar” ose origjinali i lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;
2. Një kopje e dokumentit të identifikimit të përfaqësuesit ligjor/administratorit të shoqërisë që paraqet kërkesën në emër të kësaj të fundit;
3. Në rast se kërkesa paraqitet nga një person i autorizuar nga subjekti i të dhënave, asaj i bashkëngjitet dhe një prokurë origjinale apo autorizim i posaçëm, i lëshuar nga subjekti i të dhënave për personin e autorizuar, si dhe një kopje e dokumentit të identifikimit të këtij të fundit;
4. Mandat pagesa me përshkrimin sipas Aneksit 3.